



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:187225

Datë: 19.08.2024

Numri i dokumentit: 06105177

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Vjosa Hasani, në çështjen juridike të paditëses A.V. nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson Visar Musa avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, cilin me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “D.” me seli në Prishtinë, për çështjen juridike kompensimi dëmi material dhe jo-material, në seancën e mbajtur me datë 10.06.2024, mori, ndërsa më datë 01.08.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit paditëses A. V., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), që paditëses A.V., në emër kompensimit të dëmit të pësuar, t`ia paguaj shumat si vijojnë:

**1. në emër të dëmit jomaterial:**

- për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej .....7,000.00€,
- për frikën e përjetuar shumë prej .....5,000.00 €,
- për zvogëlimin e aktivitetit jetësor 5 % shumë prej .....5,000.00€,
- për shëmtim trupor shumë prej .....4,000.00€,

**2. në emër të dëmit material:**

- për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumë prej .....400.00 €,
- për ushqim të përforcuar shumë prej .....350.00 €,
- për shpenzime në fatura në shumë prej.....1,918.00€

**Gjithsej shuma prej: 19,168.00€**

**II.** E paditura obligohet të bëjë kompensimi e dëmit në shumë të përgjithshme prej **19,168.00€**(nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro) të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditëses, së bashku me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurë në shumë prej **1,419.20 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë si e pa bazuar e paditësit përtej vlerave të aprovuara, për dhimbje fizike shumë prej 10,000.00€, për frikën e përjetuar shumë prej 3.000.00€, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 6.000.00€, për shëmtim trupor shumë prej 5.500.00€ si dhe për shpenzime të sherimit shumë prej 895.45€, **si të pabazuara.**

**IV. OBLIGOHET** propozuesi, që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumë prej 80.00 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë

### **A r s y e t i m i**

Paditësja A.V., nga Ferizaj, më datë 13.09.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo-material, si rezultat i aksidentit të datës 03.07.2022.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, me padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në precizimin e kërkesëpadisë dhe fjalës përfundimtare ka thënë se pas administrimit të provave dhe nga fakti se nuk ka qenë kontestuese baza juridike kërkesëpadisë, por konstatuese ka qenë natyra e lëndimeve të cilat janë konstatuar nga ekspertizat mjekësore. I ka propozuar gjykatës që të aprovon kërkesëpadinë paditëses si dhe precizimin e kërkesës së datës 03.04.2024 dhe kërkojnë nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesë padia e paditëses ashtu siç është precizuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas parashtrësës së precizuar.

E paditura, në përgjigjen e saj në padi, në gjatë shqyrtim kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Mbes në tersi pranë të thënave dhe deklarime si në përgjigje në padi, duke e ritheksuar se e paditura nuk e konteston bazës juridike të kërkesë padisë, mirëpo e

konteston vetëm lartësinë e shumës së precizuar sipas parashtrësës. I ka propozuar gjykatës që në rastin e vendosjes të aprovoj kërkesën bazuar në kriteret gjyqësore dhe praktikes gjyqësore me që shuma e kërkuar është tejet e lartë. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës të vendos konform nenit 425 pika 2 e LPK-ës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si në vijim: *Raportin e aksidentit dhe raportin e policit hetues, me skicë të vendit të ngjarjes nr. rasti 2022-CFT-393, i datës 03.07.2022 si dhe. Ekspertizën mjekësore e ekspertëve ortoped dr. M.H. dhe psikiatër dr. V. S.-A. e dt. 23.03.2024.*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 paragrafi 1 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nga ana e te paditurës nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por vetëm kërkesëpadia sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit material dhe jo material, por i ka cilësuar shumat e kërkuara nga ana e tyre si tejet të larta, të pabazuar dhe jo në përputhje me dëmin e shkaktuar palës paditëse. Si rezultat i kësaj gjykata ka caktuar ekspertizat mjekësore për të vërtetuar lartësinë e kërkesë padisë.

Eksperti Dr. S.S.A.-psikiatër, në ekspertizën e hartuar me shkrim me datën 23.03.2024, ka dhënë mendimin e saj profesional, sipas së cilit, është konstatuar se paditësja A.V., pas leximit, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës në emër të paditëses dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ka dhënë mendim: se paditësja ka përjetuar frikë primare disa sekonda që nënkupton momentin e aksidentit kphen brenda se cilës paditësja ka përjetuar ndjenjën e përfundimit të fatal dmth. Frikë nga vdekja, frikë sekondare e cila nënkupton prishjen e stabilitetit psiko-social, ankth, pagjumësi dhe dhimbje dhe këto kualifikohen si: frikë sekondare me intensitet të lartë ka zgjatur për rreth 5 ditë, frikë sekondare me intensitet mesatar ka zgjatur për rreth tetë javë, ndërsa frikë sekondare me intensitet të ulët ka zgjatur 6 muaj, e cila është manifestuar me ankth, gjumë jo të rehatshëm.

Ndërsa eksperti Dr. M.H.– ortoped-traumatolog, ka hartuar ekspertizën me shkrim me datën 23.03.2024, ka dhënë mendimin e tij profesional, sipas së cilët, është konstatuar se

paditësja – A.V., pas ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës në emër të paditëses, ka dhënë mendim: se paditësja ka pasur ka pësuar dëmtime plagë prerëse shkyese në kokë, në pjesën e ballit në anën e majtë, thyerje shumë pjesëshe e kockës së krahut të djathtë në pjesën e sipërme ku formohet nyja e krahut, ndrydhje gjoksi të cilat cilësohen si lëndime të rënda trupore. Sa i përket dhimbjeve fizike, të intensitetit posaçërisht të lartë ka përjetuar rreth 60 minuta, dhimbje të intensiteti të rëndë 3 ditë, dhimbje të intensitetit mesëm 40 ditë dhe dhimbje me intensitet të ulët ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë sforcimeve dhe ndryshimeve klimatike. Ndërsa zvogëlimi trupor jetësor është në shkallën 5%. Shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të mesme.

Sa i përket ushqimit të përforcuar ka qenë i nevojshëm 40 ditë, që do të thotë ushqim i pasuruar me proteina, minerale dhe karbohidrate. Ndihma dhe kujdesi i nga personi i trete ka qenë 40 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga persona tjerë, ndihmë e ofruar për personin e lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike.

Sa i përket rehabilitimit fiziatriko-psikik ka qenë 25 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve të nyjeve të dorës së djathtë (krahut, bërrylit), qafës, belit si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit.

Eksperti edhe në seancën e datës 10.06.2024 ka mbetur në tërësi në ekspertizën e punuar me shkrim lidhur me konstatimet dhe lëndimet e pësuar nga paditësja në aksident duke theksuar se paditësja ka pasur dy ndërhyrje operatore njëra në kohën e lëndimit ku është operuar dhe i është vendosur materiali sintetik dhe operimi tjetër më datën 17.05.2023 ku i është hequr materiali i vendosur në operacionin e parë. Ndërsa sa i përket zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm në shkallë prej 5% manifestohet në vështirësi, ngritje, kontrollim dhe kufizim të lëvizjeve të krahut të djathtë.

Gjykata, për të gjitha këto forma të dëmit jo material, paditësit i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, dhe atë për shkak të dhimbjeve fizike i ka aprovuar shumën prej 5.000.00€, për frikën e përjetuar i ka aprovuar shumën prej 4.000.00€, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallë prej 5% i ka aprovuar shumën prej 3.000.00€, për shëmtim trupor i ka aprovuar shumën prej 4.500.00€, si vlera reale të mbështetura edhe nga praktika gjyqësore dhe duke u bazuar edhe në bindjen e saj të lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor, me synim

se vlerat e gjykuara paditësja kurrë nuk do të mund t'ia rikuperonin gjendjen shëndetësore që kishte para aksidentit, por se atij ky zhdëmtim do t'i shërben si satisfaksion moral, për të mirat e që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të saj dhe kjo pagesë tek ajo do të ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit të saj, duke krijuar tek ajo ndjenjën e besimin, për t'iu qasur rrjedhave të zakonshme të jetës normalisht.

Gjykata, paditëses i ka gjykuar në emër të dëmit material, për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë shumë prej 400.00€, për ushqimin e përforcuar shumë prej 350.00€, shpenzimet e faturave 1,918.00, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja, që për gjykatën e bënë të besueshëm faktin se paditësja doemos ka pasur nevojë për ndihmën e një personi të tretë, për ushqim të përforcuar dhe për nevoja mjekësore(shërime), për të kryer nevojat më elementare jetësore, si dhe faturat të cilat barna i ka përdorur me rekoamndim të mjekut për shërim. Këtë vlerësim gjykata e mbështet në vlerësimin e saj të lirë bazuar në nenin 323 të LPK-së ndërlidhur me konstatimet mjekësore, për faktin se tani është notore për gjykatën, që paditësja ka shfrytëzuar ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar dhe shërbimet mjekësore, andaj gjykata ka gjykuar shumat e lartcekura duke mbështetur në ligjin mbi detyrimet, mbi bazën e bindjes së saj të lirë dhe praktikës gjyqësore.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 të LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169, 174, 182, 183 dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimet e ekspertëve të dhëna gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, të cilëve gjykata ia ka falur besimin në tërësi, mendimet e tyre të cilat i kanë dhënë me shkrim, si dhe duke u mbështetur nga dokumentacionit mjekësor dhe provat tjera, të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat janë administruara si prova në këtë çështje juridike, e që në këtë rast me këtë kompensim nuk ka qëllimin e rikthimit të mirës së dëmtuar tek paditësja, por se ka për qëllim rivendosjen e ekuilibrit të ç' rregulluar në gjendjen shpirtërore të paditëses, duke i dhënë asaj një satisfaksion moral, se dikush është gjetur fajtor për dëmtimin e shëndetit të tij, për këtë gjë i është detyruar atij me këtë formë të "shpërblimit të dëmit të plotë", i cili kompensim nuk do të kuptohet assesi si kompensim absolut i dëmit të shkaktuar.

Gjykata shumat e refuzuara përtej vlerave të aprovuara për dhimbje fizike shumë prej 10.000.00€, për frikën e përjetuar shumë prej 3.000.00€, për zvogëlim të aktivitetet jetësor shumë prej 6.000.00€, për shëmtim trupor shumë prej 5.500.00€, i ka vlerësuar si të pabazuara dhe tejet të larta duke u bazuar në praktikën gjyqësore dhe bindjen e lirë.

Gjykata lidhur me kamatën e llogaritur ka vendosur bazuar në nenin 278 lidhur me nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse paditësja ka pasur sukses në pjesën e konsiderueshme të pretendimeve të tij, gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t`ia kompensoj shumën prej 1,419.20€ dhe atë për padi shumën prej 208.00€, për tri seanca të mbajtura nga 270.00€ apo shuma prej 811.20€, për përpilimin e ekspertizave mjekësore (ortopedi+psikiatri), shumën prej 300.00€ si dhe taksën gjyqësore për padi në shumën prej 100.00€.

Gjykata bazuar në UA, në fuqi ka obliguar propozuesin që të paguaj taksën shtesë në emër të padise në shumën prej 80.00€, në bazë të vlerës së kërkesës në afat prej 15 dite nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr. 2022:187226 me datë 01.08.2024**

**Gjyqtari,  
Bekim Salihu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.